




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA E KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPKI</u>	Nr Prot. Br. Prot. <u>06-3354/19</u> Prot No.
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u> Nr. pages	Data Datum <u>19.12.2019</u> Date
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.12.2019, mori:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI-01/19/06*, për zyrtarin e lartë z. Fatmir Aliu, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë, për shkak të është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.**
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.**

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-DPKI-01/19/06, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Fatmir Aliu, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë, është zhvilluar procedura e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtuqjeshëm: Agjencia), pasi ka identifikuar rastin për zyrtarin e lartë z. Fatmir Aliu, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë, ka verifikuar informacionin ku i njëjti figuronte si Person i Autorizuar në biznesin privat "Fatmir Al. Aliu" B.I.. Fillimisht, Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-06-02380/19, ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (në tekstin e mëtuqjeshëm: ARBK), verifikimin dhe konfirmimin e informacionit lidhur me biznesin e cituar mësipër. Nga përgjigja e ARBK-së (shkresa zyrtare nr. DPKI-06-2380-1/19), rezulton se zyrtari i lartë z. Fatmir Aliu përveç se është pronar, i njëjti është edhe person i autorizuar në biznesin në fjalë.

Me rastin e konfirmimit se zyrtari i lartë z. Fatmir Aliu, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë, është njëkohësisht edhe Person i Autorizuar në biznesin privat,



Agjencia në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-01/19/06, dhe se në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese, ai ka të drejtë të njoftohet gjerësisht me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin në fjalë.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga pala, me kërkesë të tij është organizuar dhe mbajtur një takim brenda Agjencisë, ku zyrtari i lartë është njoftuar gjerësisht lidhur me faktin se, ushtrimi i funksionit të Gjyqtar si dhe të qënurit njëkohësisht Person i Autorizuar në biznesin privat, paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, situatë e cila është në kundërshtim me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Fatmir Aliu është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke prezantuar fillimisht Vendimin mbi Shlyerjen nga Regjistri i Odës së Avokatëve (OAK) të Kosovës, nr. 559115, të datës 20.05.2015, si dhe duke deklaruar se që nga nxjerrja e këtij vendimi nga ana e OAK-së, dhe emërimit si Gjyqtar, nuk ka ushtruar asnjë lloj veprimtarie me biznesin në fjalë. Gjithashtu z. Fatmir Aliu ka deklaruar se do të ndërmarr veprime tjera konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Me datë 12.12.2019, Agjencia ka pranuar shkresë zyrtare me të cilën dëshmohet se z. Fatmir Aliu iu ka bërë kërkesë institucioneve përkatëse për shuarje të biznesit. Ndërsa më 18.12.2019, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-2533-1/19) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Fatmir Aliu, ka shuar në tersi biznesin dhe i njëjti nuk figuron më të jetë Person i Autorizuar e as pronar i biznesit privat “Fatmir Al. Aliu” B.I.”.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Fatmir Aliu, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë, duke u tërhequr nga pozita e Personit të Autorizuar në biznes, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havollari
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

